

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Emine Mustafa dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurave: M.Sh. dhe H.Z. për shkak të veprës penale trajtim i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.4 lidhur me par.1 të KPK dhe V.K. për shkak të veprës penale mosdhënia e ndihmës mjekësore nga neni 261 par.3 lidhur me par.1 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga Prokurori i Shtetit të Kosovës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.114/2016 datë 31.5.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.324/2017 datë 27.9.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më 27 mars 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të Kosovës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.114/2016 datë 31.5.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PAKR.nr.324/2017 datë 27.9.2017.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.114/2016 datë 31.5.2017, të pandehurat M.Sh. dhe H.Z. në pajtim me dispozitën e nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPK, janë liruar nga akuza, për shkak të veprës penale trajtim i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.4 lidhur me par.1 të KPK, ndërsa e pandehura V.K., për shkak të veprës penale mosdhënia e ndihmës mjekësore nga neni 261 par.3 lidhur me par.1 të KPK. Është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.324/2017 datë 27.9.2017, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorit të Shtetit, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, Prokurori i Shtetit të Kosovës ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që të konstatohet shkelja e Ligjit të Procedurës Penal dhe Kodit Penal të Kosovës.

Përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurës M.Sh., F.L., avokat nga P., duke propozuar që kërkesa e Prokurorit të Shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa konstatoi se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Siç rezulton nga shkresat e çështjes dhe aktgjykimet e kundërshtuara, të pandehurat M.Sh. dhe H.Z. me aktakuzën PP.I.nr.74/2016 datë 18.05.2016, janë akuzuar për shkak të veprës penale trajtim i pandërgjegjshëm mjekësor nga neni 260 par.4 lidhur me par.1 të KPPK, sepse më datën 3.3.2016 në mes të orës 07:30 dhe 10:45, në spitalin regional në Gjilan, në repartin e gjinekologjisë – salla e lindjes, H.Z. si mjeke kujdestare, gjatë lindjes së pacientes tani të ndjerës A.S.-S., kanë përdorur mjetet e papërshtatshme të mjekimit duke dhënë barëra të cilat nuk kanë qenë adekuat për ndalimin e gjakderdhjes nga mitra dhe si pasojë e gjakderdhjes së madhe dhe vonesës së intervenimit kirurgjik, pacientja pëson shok hemorragjik për shkak të cilit vjen deri te vdekja. Ndërsa, e pandehura V.K., për shkak të veprës penale mosdhënia e ndihmës mjekësore nga neni 261 par.3 lidhur me par.1 të KPK, e cila më datën 2.3.2016 nga ora 17:00 deri më 3.3.2016 rreth orës 8:20 minuta në të njëjtin spital, si mjeke kujdestare, në kundërshtim me detyrat ka refuzuar, nuk i ka ofruar ndihmën mjekësore tani të ndjerës A.S.-S., para aktit të lindjes, nuk i ka dhënë medikamente të përshtatshme për lindje normale dhe pas përkeqësimit të gjendjes shëndetësore të pacientes dhe bebes së saj është thirre por ajo ka refuzuar dhe për shkak të komplikimeve shëndetësore e ndjera pëson shok hemorragjik dhe në orën 11:05 ndërron jetë.

Në kërkesën e Prokurorit të Shtetit pretendohet se aktgjykimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 370 par.7 të KPPK, sepse në arsyetimin e aktgjykimeve nuk janë dhënë arsye për saktësinë e provave respektivisht për kundërthënie ne mes të deklaratës së të pandehurës M.Sh. dhe sqarimeve të dhëna nga Dr. B.C. në shqyrtimin gjyqësor më datë 24.3.2017. Më pas Prokurori citon konstatimin e kësaj eksperte lidhur me

shkakun e vdekjes së tani të ndjerës duke theksuar se gjetjet e ekspertizës janë në kundërshtim me historinë e pacientes ku nuk janë shënuar asnjë nga simptomat e konstatuara në ekspertizë. Më pas potencohet se as ekspertja në fjalë nuk ishte e sigurt për diagnostifikimin e embolisë nga lëngu amnial, për çfarë ka rekomanduar që të bëhen ngjyime jashtë vendit.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se pretendimi në fjalë nuk është i bazuar për faktin se të dy gjykatat në aktgjykimet e tyre lidhur me të gjitha faktet vendimtare kanë dhënë arsye të plota ligjore. Pra, aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë të paqartë dhe kundërthënës me vetveten, me arsyetimin apo me shkresat e çështjes në veçanti nuk ka kundërthënie në mes të ekspertizave të kryera në dy nivele.

Vlen të theksohet se e pandehura M.Sh., ka deklaruar se lëngu amnial është konstatuar në bazë të ngjyimit të thjeshtë, mirëpo, deklarimi i saj në këtë pjesë, ka të bëjë vetëm me interpretimin e gjetjes së ekspertës Dr. V.K., e cila në raportin e saj ka konstatuar se prezenca e lëngut amnial është konstatuar në bazë të ngjyimit të thjeshtë, të cilin konstatim ka pranuar edhe komisioni i katër ekspertëve, për çfarë do të flitet më poshtë në këtë aktgjykim.

Për më tepër, ekspertiza e dytë, është kryer nga komisioni multidisciplinar i përbërë nga 4 ekspertët dhe atë: Dr. B.C. – specialiste e mjekësisë ligjore dhe specialiste patologe e cila ishte udhëheqëse e komisionit, Dr. S.L.-patologe, Dr. I.K.-anestezilog dhe Dr. F.A.-gjinekolog. Dr. B.C., është dëgjuar edhe në shqyrtimin gjyqësor kur ka dhënë sqarime lidhur me konkludimet e paraqitura në raportin me shkrim. Kjo ekspertizë është e qartë dhe nuk ka kundërthënie me prova tjera, në veçanti me konstatimin e ekspertit Dr. A.G., i cili ka ekzaminuar trupin e pajetë tani të ndjerës dhe Dr. V.K., e cila ka asistuar autopsisë dhe në raportin e saj, ka konstatuar disa ndryshime në mushkri, të cilat me besueshmëri i përkasin përbërësve të lëngut amnial. Nga ana tjetër, edhe e katër ekspertët në konkluzionin e dhënë kanë theksuar se shkaku i vdekjes së të ndjerës, dyshohet të ketë qenë embolia e lëngut amnial dhe nuk janë gjetur shkelje të protokolleve klinike të trajtimit, nuk janë gjetur ndryshime mikroskopike dhe makroskopike të cilat flasin për atoni të mitrës. Pra, edhe ky komision pranon faktin të cilin ka konstatuar ekspertja Dr. V.K. – histopatologe lidhur me prezencën e përbërësve të lëngut amnial dhe pajtohet se shkaku i vdekjes dyshohet se është embolia e lëngut amnial, me një konstatim se për të përcaktuar diagnozën definitive rekomandohet të bëhen ngjyrimet speciale në ndonjë institucion jashtë vendit, meqë kjo nuk bëhet në Kosovë. Pra, këto dy ekspertiza dhe sqarimet e ekspertës Dr. B.C. janë plotësisht identike, sipas të dyjave dyshohet se shkaku i vdekjes ka qenë prezenca e lëngut amnial. Për më tepër, ekspertja ka shpjeguar se çështja e lëngut amnial është problem botëror dhe kjo diagnozë nuk është e mundur të jetë ditur nga ana e të pandehurave sepse klinikisht kjo nuk mund të diagnostifikohet në shumicën e

rasteve. Sipas ekspertëve shkaku i vdekjes së tani të ndjerës nuk ka qenë shoku hemorragjik siç pretendon prokurori në kërkesën e tij.

Pretendimi tjetër i Prokurorit të Shtetit është se ekspertja Dr. B.C., se në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk ka pasur informata për terapinë e pacientes dhe çka ka ndodhur me të kështu që në kuptim të nenit 138 par.1 pika 1.3 lidhur me par.3 të KPPK, kjo provë është e papranueshme. Kjo Gjykatë vlerëson se as ky pretendim nuk është i bazuar për faktin se dispozita në të cilën thirret Prokurori i Shtetit, ka të bëjë me përmbajtjen e raportit të ekspertimit respektivisht formën e tij, ndërsa paragrafi 3 i të njëjtës dispozitë përcakton nëse raporti i ekspertit nuk është në pajtim me këtë nen, nuk është i pranueshëm. Prokurori me këtë pretendim nuk specifikon për çfarë arsye kjo ekspertizë nuk është në pajtim me këtë dispozitë prandaj pretendimi del si i pabazuar.

Pretendimi tjetër i prokurorit është se provat e administruara nuk janë vlerësuar drejt dhe në përputhje me ligjin, në veçanti deklarata e dëshmitares M.Gj. të dhënë në prokurori më datë 15.4.2016 e cila ka deklaruar se gjatë kohës deri sa e ndjera ishte duke lindur në sallë, nuk ka prezantuar asnjë mjek në përjashtim të mamisë B.F. Po ashtu, thuhet se as sms-të e këmbjera në mes të P.S. dhe tani të ndjerës, nuk janë vlerësuar sepse nga të njëjtat rezultan se të ndjerës nuk i është ofruar ndihma mjekësore gjë që pohon edhe dëshmitari A.E., i cili ka thënë se e ndjera nga faza e lindjes deri te faza e operacionit ka qenë në parametrat minimal të jetës për shkak të humbjes së sasisë së madhe të gjakut.

Pretendimi në fjalë nuk është i bazuar, për faktin se të gjitha provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, janë vlerësuar në harmoni me dispozitën e nënti 361 par.2 të KPPK dhe në frymën e kësaj dispozite është vlerësuar edhe deklarata e dëshmitares së potencuar në kërkesë si dhe sms të këmbjera në mes të dëshmitares dhe të ndjerës, ashtu që nga sms-të siç drejt konkludon gjykata e shkallës së parë, nuk mund të vërtetohet ndonjë fakt relevant nëse e ndjera ka kërkuar ndihmë apo jo dhe nëse e pandehura V., ka refuzuar që t'i ofroj ndihmë ndërsa, fakti se mamia ka qenë prezente gjatë lindjes, nuk ka qenë kontestues dhe për këtë kanë pohuar edhe të pandehurat sepse lindja ka qenë normale pa ndonjë veçori dhe komplikim, ndërsa në momentin kur janë paraqitur komplikimet, të gjithë të pandehurat kanë qenë afër pacientes. Për të gjitha këto të dy gjykatat kanë dhënë arsye të qarta ligjore të paraqitur në aktgjykimin e tyre të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Konkludimet e gjykatës së shkallës së parë të cilat i ka konfirmuar edhe ajo e shkallës së dytë janë rezultat i vlerësimit të drejtë të provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor dhe si rrjedhojë drejt është zbatuar edhe ligji.

Duhet të theksohet se sipas përkufizimit të nenit 260 të KPK, përcaktohet se kjo vepër penale konsumohet kur mjeku i cili me rastin e dhënies së ndihmës përdor haptas një mjet apo metodë të papërshtatshme të mjekimit ose nuk përdor masat

përkatëse higjienike dhe me këtë shkakton keqësimin e gjendjes shëndetësore të personit ndërsa sipas paragrafit 4 të njëjtës dispozitë element cilësues i veprës paraqitet vdekja një apo më shumë personave.

Nga aktakuza nuk mund të vërtetohen metodat apo format konkrete të papërshtatshme të cilat në kuadër të kompetencës profesionale kanë ndërmarrë të pandehurat, po ashtu nuk mund të kuptohet cilat kanë qenë medikamentet apo veprimet të cilat pretendon Prokurori në kërkesë, që nuk i janë dhënë tani të ndjerës gjatë procesit të lindjes dhe, se si konsideron se e pandehura V., ka refuzuar që pacientes t'i ofrojë ndihmë, pra në të cilat prova bazohen këto pretendime sepse nga shkresat e lëndës siç edhe është elaboruar më lartë është evidente se në rastin konkret metodat e përdorura nga të pandehurat kanë qenë sipas standardeve mjekësor, dhënia e terapisë sipas parametrave dhe veprimi i fundit i ndërmarr ishte operacioni i cili është bërë sipas standardeve.

Nga sa u tha më lartë e në kuptim të dispozitës së nenit 437 të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr. 331/2017, më 27 mars 2018

Procesmbajtësi,
Sherif Krasniqi

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta